



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 79 datë 30.11.2022

**Mbi lënien në fuqi të nivelit të Gjobave për vitin 2023, sipas Vendimit të KB nr.65 datë 26.11.2021 për "Miratimin e vendosjes së gjobave, për shkeljet që përbëjnë kundravajtje administrative për vitin 2022, në Bashkinë Vau Dejës"**

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Per kundravajtjet administrative", i neni 6, pika b, neni 10, pika,3, Ligji Nr. 10433, date 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqiperise"ligji Nr. 8224, date 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë bashkiake", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Lënien në fuqi të nivelit të Gjobave për vitin 2023, sipas Vendimit të KB nr.65 datë 26.11.2021 për "Miratimin e vendosjes së gjobave, për shkeljet që përbëjnë kundravajtje administrative për vitin 2022, në Bashkinë Vau Dejës";
2. Efektet shtrihen nga 01.01.2023 deri me 31.12.2023;
3. Ngarkohen Sektori Taksave dhe tarifave Vendore, Bashkia Vau Dejes per zbatimin e ketij vendimi;
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 05.12.2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 6831/1 Prot

Dt. 19.12.22



Shkodër, më 14.12.2022

Nr.895/1 prot.

**LËNDA: Mbi vendimin Nr. 79 date. 30.11.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.**

### KESHILLIT BASHKIAK VAU-DEJES

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji Nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 23,26,27,29, nenit 55/3, nenit 64/c, ligjit Nr.10279 dt.20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative” neni 6 germa b, neni 7 germa ç, neni 10, pika 3, neni 20, ligjit nr.8224 dat.15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë bashkiake” i ndryshuar, VKM Nr.1029 dat.28.12.2015 “Per miratimin e rregullave, kushtave e procedurave per perdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, neni 1, materialit të depozituar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Vau-Dejës Nr.3552prot date.30.11.2022 “Mbi dërgimin e dokumentacionit shoqërues të mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau-Dejës te dates.30.11.2022”, *analizoi VKB Vau-Dejës nr.79 datë 30.11.2022 Mbi lënien në fuqi të nivelit të gjobave për vitin 2023, sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.65 date.26.11.2021 “Për miratimin e vendosjes së gjobave, për shkeljet që përbëjnë kundravajtje administrative për vitin 2022, në Bashkinë Vau-Dejës”.*

Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.  
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**Majlinda ANGONI**

